

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **KOMUNA E PODUJEVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **615-25-3027-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me inventar**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>SOPA TECH SH.P.K.</b>
NUI	<b>812167486</b>
Adresa	<b>Gracke e Vogel</b>
Vendi	<b>Lipjan</b>
Kodi postar	<b>14000</b>
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Muzafer Sopa</b>
Adresa elektronike	<b>techsopa@gmail.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>16.05.2025</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

#### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**Furnizim me inventar**

**Furnizim me inventar**

#### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☐

Jo ☒

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☐

Jo ☒

#### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☒

Jo ☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

**Ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim, por është refuzuar pa të drejtë si kinse e pabazuar**

#### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Ligji i Prokurimit Publik

Neni 1 Qëllimi

Neni 2 Fushëveprimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi  
Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale  
Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare  
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale  
Neni 70 Standardet për Sigurimin e Cilësisë

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

### **I. HYRJE**

1. Autoriteti kontraktues, me datën 23.04.2025 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me inventar" me anë të së cilit ka kërkuar oferta për furnizim me inventar nga operatorët ekonomik. Data e fundit për dorëzimin e ofertave është përcaktuar data 05.05.2025, andaj Parashtruesi i ankesës brenda afatit ka paraqitur një kërkesë për rishqyrim për të kundërshtuar kriteret diskriminuese të dosjes së tenderit.

2. Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit ka përcaktuar një varg të kriterëve ekonomike dhe administrative të cilat bien ndesh me parimet dhe rregullat e prokurimit publik si dhe ngushtojnë konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik në masë shumë të madhe. Autoriteti kontraktues ndër të tjera ka përcaktuar edhe këto kriterë: "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjajshme në vlerë minimale prej 180,000.00 Euro, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë). Në rast të formimit të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 51% të shumës së kërkuar në furnizime të ngjajshme të realizuara në tre vitet e fundit". Në këtë rast shtrohet pyetja se pse është kërkuar maksimumi ligjor si qarkullim për operatorët ekonomik dhe çfarë të mire ka komuna në rastin përkatës me këtë kriter që ka përcaktuar. Një kriter i tillë i dëmton ndërmarrjet e vogla të cilave u pamundësohet të marrin pjesë në këtë aktivitet të prokurimit.

3. Kriter tjetër i panevojshëm dhe i paligjshëm është edhe kriteri: "2.(Një) Inxhinier i diplomuar me (bachelor ose master) i Arkitekturës së Enterierit dhe Dizajni i Mobileve, minimum me – 5 - vite përvojë pune pas diplomimit." Në një aktivitet të prokurimit ku të gjitha specifikacionet teknike dhe funksionale janë përcaktuar me dosjen e tenderit dhe aneksin 1, një inxhinier i enterierit dhe dizajnit të mobiljeve çfarë pune do të bëjë, kur kjo çështje veç është përcaktuar nga komuna në dosjen e tenderit. Duke marrë parasysh se dizajni dhe të gjitha çështjet e tjera janë të përcaktuara një inxhinier i tillë konsiderohet tejet i panevojshëm. Për më tepër një inxhinier i tillë është shumë i rrallë dhe ekziston rreziku që me kërkesa të këtij lloji ky tender të jetë kurditur për ndonjë operator ekonomik

të caktuar. Prandaj kërkojmë nga Komuna që ta heq të njëjtin nga dosja e tenderit për ti hapë rrugë një konkurrence të vërtetë dhe të ndershme në mes të operatorëve ekonomik.

4. Kriter tjetër i panevojshëm për të njëjtat arsye sikurse janë theksuar më lartë është edhe kriteri: “(Një) Inxhinier i diplomuar me (bachelor ose master) i Industrisë së drurit si dhe përpunimit të drurit, i Specializuar në Dizajn të drurit, minimum me 5 vite përvojë punë pas diplomimit.” Çka i duhet komunës së Podujevës ky inxhinier kur kemi të bëjmë me furnizim të artikujve të parapërcaktuar nga ana e autoritetit kontraktues. Në këtë rast favorizohen kompanitë podhuese dhe dëmtohen ato tregtuese të cilat nuk kanë nevojë të kenë inxhinier të tillë brenda kompanisë.

5. Po ashtu edhe një kriter krejt absurd është: “4.Të paraqitet stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesional. Menaxheri i projektit të jetë Inxhinier i diplomuar me (bachelor ose master) Industrisë së drurit si dhe përpunimit të drurit, i Specializuar në Dizajn të drurit, minimum me 5 vite përvojë punë pas diplomimit.” Pra kërkesa për menaxher të projektit që të jetë i specializuar në dizajn të drurit është krejtësisht qesharake, pasi pozita e menaxherit është administrative dhe caktimi i një inxhinieri nga fusha e dizajnit të drurit nuk ka asnjë kuptim. Në anën tjetër kërkesa për përvojë pesë vjeçare është arbitrare dhe totalisht e padobishme për këtë aktivitet të prokurimit.

6. Në dosjen e tenderit janë kërkuar edhe pajisje si: “Listën e paisjeve, mjeteve, makinave teknike mbi pronësinë 1-.Kamjon transportus, 1-.Furgon transportus, 1-.Makin CNC, 1 .Makinë Sharr, 1-.Makin Shiritore (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve, pajisjeve teknike dhe kapacitetet tjera të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të Tenderit). Lista paisjeve dhe mjeteve, makinave teknike të OE duhet të jetë origjinale , e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik, duhet të ofroj si dëshmi, Libreza, për paisjet që nuk regjistrohen të deshmohen me dud doganor ose Fature.” Të gjitha këto pajisje i favorizojnë kompanitë prodhuese andaj me respekt kërkojmë që të njëjtat të hiqen nga kjo dosje e tenderit.

7. Në dosje të tenderit janë kërkuar edhe një varf i standardeve ISO të cilat nuk janë fare relevante me këtë aktivitet të prokurimit pasi që aty kërkohen: "8.Certifikate- ISO 9001 2015 ISO 14001 2015, ISO 45001 2018, të gjitha Certifikatat Valide. Dëshmia 8.Certifikate- ISO 9001 2015 Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ISO 14001 2015,Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit ISO 45001 2018, Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shendetit në Pune. të gjitha Certifikatat Valide." Këto ISO standarde janë tejet të panevojshme dhe paraqesin vetëm barrë administrative për operatorët, pasi që dihet tanimë se këto certifikime janë fiktive në Kosovë, pasi që asnjë laborator me certifikim dhe akreditim ndërkombëtar nuk ka përfaqësi në Kosovë.

8. Autoriteti kontraktues ka kërkuar edhe: "11.Para hapjes së ofertave, të gjithë pjesëmarrësit janë të obliguar të dorëzojnë mostrat për artikujt me nr rendor artikulli 2, 7, 9, 13, 60, 61, 67, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 91 që përfshihen në ofertë. Mostrat duhet të jenë të identifikuara me numrin e artikullit dhe përshkrimin përkatës, sipas specifikimeve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mostrat do të shqyrtohen nga

komisioni i vlerësimit për të verifikuar përputhshmërinë me kërkesat teknike dhe cilësore të përcaktuara. Dorëzimi i mostrave duhet të realizohet me se largti deri në ditën e hapjes së ofertave në ora 12 00, dhe çdo ofertë pa mostra do të konsiderohet e paplotë dhe e papranueshme." Në rastin konkret mostrat duket se janë kërkuar vetëm për të eliminuar konkurrencën pasi që porositja prodhimi dhe transportimi i këtyre mostrave dihet se merr një kohë të konsiderueshme, andaj edhe afati i shkurtër në këtë aktivitet të prokurimit nuk mundëson sjelljen e këtyre provave në kohë.

Prandaj me respekt kërkojmë nga OSHP që të aprovoj këtë Ankesë dhe këtë dosje të tenderit ta pastroj nga kriteret e paligjshme dhe diskriminuese. Me respekt për punën tuaj, kërkojmë aprovimin e kësaj ankese si plotësisht të bazuar.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Nuk ka**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.